REVISTA E KOMUNITETIT SHQIPTAR NE BRITANINE E MADHE - MAGAZINE FOR THE ALBANIAN COMMUNITY IN THE UK AND REPUBLIC OF IRELAND

# ALBANIAN POST

Nr. 42

SHKURT / FEBRUARY 2022

**Editor in Chief:** Dr. Fatmir Terziu - **Telephone:** 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com

19 Suksesi...

04 Modeli...

11 Ligj...

# DASHURIA PËR NJËRI-TJETRIN

Normale. Ja ku e nisëm përsëri botimin me një vit të ri, me një risi të re, me revistën time në print në Mbretëri të Bashkuar, “Albanian Post”. Dhe ndërsa e publikoj numrin e 42 të saj në këtë shkurt të ftohtë britanik, më duket se më mungon thjeshtësia e një batanije të përbashkët, dashuria e një mbulese të përbashkët. Por e ndjej se e kam një pikë që na bashkon dhe tejo qëndron mendja dhe zemra e të gjithëve, Atdheu, ndaj aty fiksohen momentet e lidhjes së pastër që ndjej se dikur kalonin dhe ende kalojnë në ëndrra të pikësuara nga zgjimi, duke ju parë atje dhe duke ju mbajtur përsëri afër, por kurrë sa duhet. Ne jemi të gjithë miq me një

*(vijon në faqen 02)*

**24/7 orë linjë emergjence**

**07878335000**

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

**Këshilla ligjore FALAS**

**Specialist i azilit të trafikimit njerëzor**

**RASHID & RASHID LAW FIRM**
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
**Tel:** 02085401666

*(vijon nga faqja 01)*

...vlerë të përbashkët Dashurie për njëri-tjetrin.
Më mungon kafja me Ju, tingulli i zërit tuaj, qasja e fjalëve tuaja, por Ju kam gjithnjë këtu mes meje, në faqet e kësaj reviste, që u përket brezave dhe arkivave në vite. Më mungojnë shumë gjëra për ju, është e vështirë të shpjegosh që jeni të gjithë ende këtu. Jo në mënyrë metaforike, por në fakt.
Kështu vazhdon, kështu emeton, kështu përfundon? Dikur e dinim se kështu nuk do të funksionojë më.
Ne ishim dhe mbetëm njerëz larg njëri-tjetrit, disa mijë milje larg njëri-tjetrit. Dikur ishim në gjendje të tregonim se ishim në harmoni me njëri-tjetrin. Dhe ende jemi… Jemi se jemi të gjithë Ju miqtë e mi në faqet e kësaj reviste shqiptare në Londër. Vazhdoj të jem me Ju. Ju jeni me mua? Unë e di kur zgjohem, por për ju tani nuk e di as në cilën orë zgjoheni. Më parë, çdo ndryshim në frymëmarrjen tuaj do të mjaftonte për të më zgjuar. Ju më zgjoni deri në pikën e vetëdijes, por mjafton që të jem i vetëdijshëm.
Normale.
Kjo është diçka që duket shumë larg tani.
Normale.
Ndoshta për mua kjo është normale? Jemi bashkë, të ftuar dhe të bashkuar me këtë revistë në print dhe me këtë faqe online … www.fjalaelire.com.

# NË KËTË NUMËR TË RI TË REVISTËS "ALBANIAN POST"

Në këtë numër të ri të revistës "Albanian Post" midis të tjerave do të ndiqni një përkushtim që i përket Kosovës në katërmbëdhjetë vjetroin e saj të pavarësisë. Në brendësi të këtij shkrimi do të gjeni disa fakte të cilat sot e kësaj dite kërkojnë reflektim. Më tej do të gjeni mjaft artikuj të cilët natyrisht kanë në thelb ligje dhe lighjësi të reja të përshtatjes së qytetarëve në Mbretëri të Bashkuar, me të cilët fillon dhe përqaset vetë jeta nga organet përkatëse ligjvënëse dhe ligjzbatuese në MB.
Nga faqja e Parë lexojmë atë që shfaqet si arsye normale e editorialit që thekson: "Normale. Ja ku e nisëm përsëri botimin me një vit të ri, me një risi të re, me revistën time në print në Mbretëri të Bashkuar, "Albanian Post". Dhe ndërsa e publikoj numrin e 42 të saj në këtë shkurt të ftohtë britanik, më duket se më mungon thjeshtësia e një batanije të përbashkët, dashuria e një mbulese të përbashkët. Por e ndjej se e kam një pikë që na bashkon dhe tejo qëndron mendja dhe zemra e të gjithëve, Atdheu, ndaj aty fiksohen momentet e lidhjes së pastër që ndjej se dikur kalonin dhe ende kalojnë në ëndrra të pikësuara nga zgjimi, duke ju parë atje dhe duke ju mbajtur përsëri afër, por kurrë sa duhet. Ne jemi të gjithë miq me një vlerë të përbashkët Dashurie për njëri-tjetrin."
Në faqen Katër do të lexoni mes të tjerave se "Është duke u bërë tashmë një traditë që "Gusto 272 Italian" në Preston Road, që drejton si një biznes modern nga gruaja shqiptare e talentuar, Flora Osmani, që ta nisë vitin me një anketë të miqve, kontribuesve, dashamirësve të restorantit dhe të vetë të industrisë së kulinarisë dhe ushqimit dhe mes të gjithëve, klientëve, miqve, profesionistëve, dhe ngrënësve profesionistë. Edhe një vit si ky.
Në faqen Gjashtë: 1960: Enver Hoxha dërgoi libra për disa studentë në Skoci, ku arkivat na sjellin fakte mjaft interesante.
Në faqen Tetë janë "Një sërë ligjesh të reja, teknologjia e automjeteve dhe rregulla të drejtimit të automjetit do të futen në vazhdim në vitin 2022, dhe shumë prej tyre janë zhvillime me ndikim që do të ndikojnë çdo person që do të hipë rregullisht pas timonit."
Në faqen Nëntë: Ermal Karakushi inxhinieri elektrik me shpirt profesional. Në faqen Dhjetë Deklaratë e re e ndryshimeve në Rregullat e Imigracionit.
Në faqen Njëmbëdhjetë lexojmë "Të privosh njerëzit nga shtetësia e tyre do të thotë t'u heqësh identitetin. Qindra njerëzve u është hequr shtetësia britanike në 15 vitet e fundit, sipas një studimi, duke përfshirë një burrë që ishte pa shtetësi për gati pesë vjet. Hulumtimi i kryer nga Free Movement, një faqe interneti e drejtuar nga avokatë për të ofruar informacion për ata që preken nga kontrolli i imigracionit, ka zbuluar se të paktën 464 personave u është hequr shtetësia që kur ligji që lejonte këtë praktikë u lehtësua 15 vjet më parë."
Në faqen më pas lexojmë Ikja e dhimbshme e një Njeriu duarartë si Bashkim Faslli Selimaj.
Në faqet Trembëdhjetë dhe Katërmbëdhjetë do të lexoni Falë inxinierit Gëzim Ethemi, Atdheu në syrin tuaj për të dhjetat e sekondës.
Faqet e tjera kanë mjaft materiale të volitshme. Në faqen e Nëntëmbëdhjetë do të shikoni një strategji të re biznesi nga Gazmend Cufaj, ndërsa në shkrim përkushtues do të lexoni këngëtaren Hajati, e cila e hap dhe faqen e parë me një fotografi të saj, e nis përgatitjen fituese për Eurovizion nga Londra.
Faqja Njëzetë e Dy na sjell një Reportazh interesant nga Peja historike. Dhe së fundi faqja Njëzetë e tre na jep një vëllazrim miqësor me biznesin.

GUSTO ITALIAN

„Gusto 272 Italian“ Restoranti i munguar në Londër.

Gjithsejt: 110 persona. Dy salla moderne.
Salla kryesore: 75 persona, për festa, gëzime, ditëlindje, fejesa dhe martesa, takime të ndryshme.
Salla e dytë: 35 persona, për të gjitha okazinet festive.

„Gusto 272 Italian“ kombinim i përsosur: tradicional, modern dhe me porosi.

Kualitet Cilësi Konkurrues Garanci Siguri Pastërti Respekt

Adresa: vetëm dy minuta larg nga stacioni I trenit Preston Road,
272 Preston Road; Harrow; London; HA3 0QA

Tel: 020 8904 7775
Email: info@gustoitalian.co.uk

# “GUSTO 272 ITALIAN” MODELI I ARTË PËR VITIN 2022

Është duke u bërë tashmë një traditë që “Gusto 272 Italian” në Preston Road, që drejton si një biznes modern nga gruaja shqiptare e talentuar, Flora Osmani, që ta nisë vitin me një anketë të miqve, kontribuesve, dashamirësve të restorantit dhe të vetë të industrisë së kulinarisë dhe ushqimit dhe mes të gjithëve, klientëve, miqve, profesionistëve, dhe ngrënësve profesionistë. Edhe një vit si ky. Për vitin 2021, “Gusto 272 Italian”, ishte duke rrëfyer një profesionalizëm të lartë, që u duk nga faktet, realiteti, por dhe nga pytetje e shumta dhe komentet që mbuluar ushqimet më të mira dhe postimet më të reflektueshme në rrjetet sociale, së bashku me përgjigjet e komunitetit dhe strumbullarët e koronavirusit.

Përgjigjet e tyre u gjatë gjithë kësaj kohe, me përgjigjet e transmetuara si në asnjë rend të caktuar, fokusuar në anketën më të bukur që media shqiptare e komunitetit ka organizuar duke pyetur e testuar disa klientë tashmë të shkëlqyer të këtij mjedisi ku me plotë gojën mund të themi se është një “Shqipëri e vogël” që bashkon traditën dhe komunitetet e tjera në një kënd mjaft tërhqës dhe profesional.

Biznesmeni i suksesshëm i komunitetit shqiptar, intelektuali më në zë i fushës së konstruksionit, një familjar model dhe një aktivist i dalluar, i nominuar për profesionalizëm dhe respekt human, A. N. shprehet: “ Viti i tkurrjes së marzheve dhe dërrmimit të kushteve të biznesit, por megjithatë “Gusto 272 Italian” ka ditur ta fusë të ecë përpara me hapjen pas hapjes. Tashmë unë vij sa herë që ndjehem i qetë dhe në kohë të lirë dhe shikoj se “Gusto 272 Italian” i plotëson mjaft mirë kushtet dhe efikasitetin për të qenë i sigurtë, cilësor dhe mjaft familjar. Drejtohet nga një zonjë e nderuar si Flora Osmani dhe natyrisht nderi i takon të gjithë zonjave të vizitojnë këtë restorant model”.

Një nga komunitarët më të respektuar P.M. shprehet me fjalë më të thjeshta por gjithnjë duke shtuar se “Gusto 272 Italian” është një restorant model, familjar dhe mjaft efikas, kështu që viti 2022 do ta bëjë atë akoma më të dëgjuar dhe më të vizituar. Po ashtu dhe disa famjarë që ne i kemi ndjekur gjatë festimit të disa evenimenteve, ditëlindjeve dhe arsyeve komunitare shptehen se “Gusto 272 Italian” është modeli që duhet, restoranti që ishte i munguar prej kohësh.

Deri më tani, “Gusto 272 Italian” ka mbuluar të ardhurit më të mirë, gatishmërinë e duhur dhe të kërkuar si gjithnjë dhe në këtë rast prej restoranteve, ushqimet më të mira, hapjet e duhur dhe totale në 2022, momentet më të mira dhe më të vështira të vitit 2021, mesazhet më të mira dhe më të konceptuara të ushqimit të vitit, surprizat më të mëdha të gatimit, shpresat më të mëdha për vitin 2022 dhe një vështrim se ku mund të shkojë më pas e ardhmja e vetë “Gusto 272 Italian”. Por për të përfunduar gjërat, këtu është një pyetje më e ndërlikuar: Çfarë do të ndodhë me “Gusto 272 Italian” në Londër në 2022 e më tej? Për këtë e do të jemi gjithnjë e më shumë pranë klientëve dhe vetë stafit të mrekullueshëm të “Gusto 272 Italian” në të gjithë kohën e mundshme.

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

# Këshilla ligjore FALAS

Specialist i azilit të trafikimit njerëzor

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent per t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- Zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim jurdik
- Apelim Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

**24/7 orë linjë emergjence**

**07878335000**

**Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.**

**Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.**

**RASHID & RASHID LAW FIRM**
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
**Tel:** 02085401666

# 1960: ENVER HOXHA DËRGOI LIBRA PËR DISA STUDENTË NË SKOCI

Tridhjetë e katër vjet si sot një grup studentësh nga Universiteti i Dundee thyen akullin e atyre viteve dhe vizituan Shqipërinë. Universiteti i Dundee që është një universitet kërkimor publik në Dundee, Skoci, dërgoi studentët e vetë në Shqipërinë e ngurtë të asaj kohe dhe në fakt ata vizituan disa qytete duke filluar nga Tirana, Durrësi, Kruja, Apollonia, Gjiroktastra, Saranda, Vlora dhe natyrisht ata vizituan dhe Butrintin. Ky universitet është i themeluar si një kolegj universitar në 1881 me një donacion nga familja e shquar e prodhuesve të tekstilit Baxter dhe ende nuk dihet se si këta studentë të këtij universiteti ishin ata që mundën të vizitonin atë kohë vendin komunist, që në një nga shënimet e këtij universiteti mbahet dhe si një arsye më shumë e një lidhjeje me Enver Hoxhën.

Rreth njëzetë vite më parë se ky delegacion të shkonte në Shqipëri, në ambientet e Universitetit Shqipëria ishte njohur nga një pako me libra që kishte dërguar udhëheqësi i Shqipërisë së asaj kohe Enver Hoxha. Librat e dërguara prej tij ishin një arsye më shumë që lidhja me Shqipërinë dhe Universitetin të mbahej mend dhe në disa shënime që ende kujtohen në dy kënde. Po si mbërritën librat e Enver Hoxhës, udhëheqësit komunist, në këtë universitet të Skocisë, që kishte mjaft probleme me britanikët, kur dihet acarimet e mëdha pas asaj që ndolli me Kanalin e Korfuzit?

Nga kujtimet që hedh në publik një student i këtij universiteti që ka përfunduar studimet për Kimi në vitin 1963, mësohet se një grup studentësh i kishin shkruar një letër Enver Hoxhës në vitin 1960. Ai ka shkruar në kujtimet e tij me rastin e 50 vjetorit të qëndrimit të tyre në një nga kampuset e universitetit në fjalë se "Një nga kujtimet e mia është politika e kohës. Duke qenë i gjallë për mundësitë e një shakaje të mirë, Sunshine House i dërgoi një letër liderit komunist të Shqipërisë, Enver Hoxha, duke duartrokitur arritjet e tij dhe duke kërkuar kështilla se si të ndiqnin hapat e tij." Don Mercer sqaron në këto kujtime se „Muaj më vonë, ne morëm një pako me libra nga Gjenerali Enver Hoxha, dhe vumë re se pakoja me librat e tij ishte hapur, inspektuar dhe rivulosur." Në lidhje me këtë Don Mercer shton se „Prej kohësh kam dyshuar se 'Sunshiners' janë përfshirë të gjithë në një listë simpatizantësh komunistë, dhe kjo mbetej për t'u parë!"

Gjatë vitit të tij të parë në 1959, kishte shumë miq në Airlie Hall, kështu që shtatë nga miqtë e tij David Hitchcock, Donald Mercer, Donald Collins, Ian Donald, Jonathan Ëilkie, Michael Hallam dhe John McLaren vendosën të merrnin përsipër banesën dykatëshe në 143 Nethergate e njohur si Sunshine House. Alani dhe shokët e tij të shtëpisë shikojnë me dashuri kohën e tyre midis 1960 dhe 1962 në Sunshine House: "Kemi qëndruar në Sunshine House për dy vjet duke kaluar një kohë të mrekullueshme dhe shpesh gazmore. Për shkak të afërsisë me Kampusin, shumë studentë thjesht do të shkonin për një bisedë. Nuk e dinit kurrë se kush mund të ishte aty kur të mbërrije në shtëpi. Çuditërisht ne të gjithë jemi në kontakt me njëri-tjetrin. Kalova kohë të mrekullueshme, bëra miq të mirë dhe do ta bëja përsëri.

Ajo pako librash të dërguara nga Enver Hoxha, pas shumë kontrolleve britanike, sikurse deklarohet nga vetë kujtimet e studentit, përfundoi më pas në sqarimin se nuk ishte thjesht një arsye e qartë se letra ishte dërguar nga studentë që kishin bindje komuniste, por një shaka, që mbeti gjatë në brezat e universitetit dhe si një humor tipik britanik. Humori i atyre viteve studentore që shkoi deri tek letra e dërguar Enver Hoxhës, dhe që u muar mjaft seriozisht prej tij, natyrisht tashmë është lënë mënjanë, dhe pos faktit të së shkuarës, por që sot tingëllon si një arsye më shumë për të kuptuar se si konsideroheshin komunikimet e asaj kohe mes dy botëve, që ishin në një luftë të ftohtë.



ARYA FOOD
CENTRE
Supermarketi konkurrues
Kurdish
Arabic
Albania
Kosovo
Adresa:
159-160 Parrock Street
Gravesend
DA 12 1ER
حلال
HALAL
CERTIFIED
FOOD
PRODUKTE SHQIPTARE
Kualitet
Cilësi
Garanci

# DISA NDRYSHIME TË MËDHA NË AUTOMOBILIZËM

Një sërë ligjesh të reja, teknologjia e automjeteve dhe rregulla të drejtimit të automjetit do të futen në vazhdim në vitin 2022, dhe shumë prej tyre janë zhvillime me ndikim që do të ndikojnë çdo person që do të hipë rregullisht pas timonit.

Ligjvënësit po planifikojnë të mbyllin një boshllëk që i ka lejuar shoferët të shmangin ndjekjen penale kur kapen duke përdorur pajisjet e tyre celulare pas timonit. Aktualisht, shoferët mund të penalizohen vetëm për përdorimin e një telefoni dore për 'komunikim ndërveprues' gjatë drejtimit të automjetit, që do të thotë se kushdo që përdor pajisjen e tij për të regjistruar video, për të bërë selfie, për të shkrepur foto dhe për të lëvizur nëpër muzikën e shkarkuar është në gjendje të shmangë gjobat dhe pikët.

Megjithatë, nga fillimi i vitit 2022, ministrat do të prezantojnë rregulla të reja që e bëjnë të paligjshëm përdorimin e një telefoni ose ndonjë pajisjeje të dorës pas timonit në pothuajse të gjitha rrethanat - dhe fajtorët do të marrin një gjobë prej 200 £ dhe gjashtë pikë në licencën e tyre.

Rregullat e rrepta do të zbatohen gjithashtu kur ndaloni në një semafor të kuq ose ngecni në trafik. Përjashtimi i vetëm domethënës është se drejtuesit do të jenë ende në gjendje të përdorin telefonin e tyre si një sat-nav për sa kohë që ai është i siguruar në një mbajtëse dhe telefonata pa duar. Do të lejohen gjithashtu pagesat me celular në restorantet me makinë ose në rrugët me pagesë.

Një përditësim i planifikuar i Kodit të Autostradave nga janari po sjellë fillimin e një sistemi zyrtar të 'hierarkisë së përdoruesve të rrugës' që është krijuar për të mbrojtur njerëzit më të cenueshëm, duke përfshirë këmbësorët dhe çiklistët. Hierarkia e re do të thotë se përdoruesit e rrugës që mund të bëjnë dëmin më të madh do të kenë përgjegjësinë më të madhe për të reduktuar rrezikun që mund të paraqesin për të tjerët. Ai do

të ketë ndikimin më të madh në kryqëzime, me shoferët që duhet të sigurojnë që të mos kalojnë shtegun e çiklistëve ose kalorësve. Dhe gjithashtu u jep përparësi këmbësorëve kur ata presin të kalojnë në një vendkalim ose kryqëzim dhe jo vetëm kur tashmë janë duke kaluar.

Bashkive në Angli dhe Uells do t'u jepen kompetenca të reja për të gjobitur shoferët deri në 70 £ për shkelje të vogla trafiku, si ndalimi në kryqëzimet e kutive të verdhë, kthesat e paligjshme dhe ngasja në korsi biçikletash në vitin 2022. Një rregullore e re që do të hartohet nga Departamenti i Transportit muajin e ardhshëm duhet të hapë dyert në pranverë për këshillat për të vendosur gjoba për këto kundërvajtje. Do të jetë hera e parë që autoritetet lokale jashtë Londrës dhe Cardiff do të kenë kompetenca për të lëshuar njoftime për akuza ndëshkuese për këto lloj shkeljesh, të cilat aktualisht zbatohen nga policia diku tjetër në Britani. Këshillat do të mund të aplikojnë për të marrë përgjegjësinë për lëshimin e gjobave për këto lloje shkeljesh nga janari, me DfT që nuk pret që kompetencat t'i dorëzohen deri në mars sa më parë. Kryeqytetet e Anglisë dhe Uellsit morën 58.2 milion £ nga dënimet për këto shkelje të vogla në 2018/19, me më shumë se gjysmën e fondeve të gjeneruara - në 31.4 milion £ - nga dënimet për shkeljet e kryqëzimit të kutive, një raport nga RAC zbuloi në 2020.

Në një përpjekje për të përshpejtuar aplikimet për rinovimin e licencave, qeveria po shqyrton ndryshimin e rregullave se kush mund të kryejë pyetësorët mjekësorë. Sipas ligjit, të gjithë shoferët duhet të plotësojnë standardet mjekësore për aftësinë për të drejtuar makinën dhe çdo vit Agjencia e Licencimit të Shoferëve dhe Automjeteve merr gjysmë milioni vendime për licencë mjekësore. Për të ndihmuar në marrjen e këtyre vendimeve, DVLA shpesh kërkon që pyetësorët të plotësohen nga mjeku ose konsulenti i shoferit.

Aktualisht, këto mund të plotësohen vetëm nga mjekët e përgjithshëm të regjistruar. Megjithatë, një konsultim që përfundoi më 6 dhjetor ngriti propozimin për lejimin e profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor, siç janë mjekët infermiere, të plotësojnë pyetësorët për të lehtësuar ngarkesën në rritje të mjekëve dhe për të ndihmuar në përshpejtimin e rinovimit të licencave.

Julie Lennard, shefe ekzekutive në DVLA, tha: "Vit pas viti ne po shohim një rritje të aplikacioneve për licencim mjekësor për shoferët dhe ne jemi vazhdimisht në kërkim të mënyrave për të përmirësuar procesin për klientët dhe profesionin mjekësor. Ky propozim do të lejonte një grup më të gjerë profesionistësh të kujdesit shëndetësor për të plotësuar pyetësorin mjekësor të shoferit, duke reduktuar barrën për mjekët e përgjithshëm dhe konsulentët.'

# ERMAL KARAKUSHI INXHINIERI ELEKTRIK ME SHPIRT PROFESIONAL

Në një kohë që emri i shqiptarit të mirë është një fakt, një krenari, një lavdi e natyrshme dhe një arsye më shumë ëpr të thënë se jemi në rrugën e duhur, një emër mjaft i respektuar, mbetet dhe përkushtimi dhe angazhimi tejet profesional i Inxhinierit të talentuar dhe me mjaft përvojë, Ermal Karakushi. Mes një përkushtimi mjaft profesional, zëri dhe puna e tij janë një pështjellë e thjeshtë dhe modeste brenda "kostumit" të profesionalizmit, brenda jelekut që ta lejon ligji dhe sigurimi teknik në profesionin e inxhinierit elektrik. Dhe natyrshëm në rreth 90% të përditësisë së tij e sheh me këtë veshje, jelekun e verdhë , gjë që tregon se ai është gjithnjë i gatshëm dhe në krye të punës së tij tejet profesionale. E kam thënë dhe herë të tjera se Ermal Karakushi, inxhinieri elektrik, njeriu human dhe specialisti i mjaftkërkuar, është j vetëm kaq, por i gatshëm të jetë një shembull jetik i shqiptarit të mirë dhe model në jetën britanike.

E gjen këtë respekt për Ermal Karakushin, edhe aty ku rastësisht hyn në bisedë për mjeshtrinë e inxhinierit elektrik, e gjen në një rastësi bisede të tjeshtë, e gjën në një mjedis profesional britanik, e gjen në Mançester, ku ka kryer mjaft punë profesionale, e gjen në Leicester, ku është bërë familjar me aftësitë e tij mjeshtërore, e gjën në Middlands, e gjen në Jorkshire, e gjen kudo e në çdo cep ku kërkohet kjo mjeshtëri. Dhe aty janë jo vetëm fjalët e respektit për të, por dhe mjaft shenja që na nderojnë edhe ne, na bëjnë krenarë edhe ne për këtë specialist, njeri model, shpirtmirë, artist në tërë humanizmin dhe profesionin e tij. Ai është njeri i thjeshtë, ai është Ermal Karakushi.
Për këtë më vijnë në kujtesë fjalët e mira e të prekshme të shqiptarëve të nderuar Shefqet Myzyraj and Qazim Sokoli, që natyrshëm thonë atë që meriton për njeriun e respektuar. "Ai është mbi të gjitha Njeri, dhe mjaft i saktë, i respektueshëm dhe plot shpirt human", të thonë ata njëzëri. Nga ana tjetër janë mjat shqiptarë që me bulën e djersës mbajnë familjet e tyre, në zonat e Barking dhe Dagenham, në Ualamsthou e më gjerë që thonë fjalët më të mira për Ermalin. Si i tillë ai është dhe një familjar model dhe mjaft i përkushtuar. Dhe kjo e bën akoma më shumë të lidhur me profesionin, jetën dhe tërë angazhimin e tij jetik.

Që nga dita e parë kur ai dëgjoi BBC-në në fjalët e saj mediatike "He's an electrician by profession" – "Ai ushtron profesionin e elektriçistit, është elektriçist", natyrshëm ndjeu dashurinë më të madhe dhe më të bukur që ndjen njeriu për të qenë i kënaqur në jetën e tij të bukur dhe plot angazhim jetik e profesional. I tillë vazhdon të jetë dhe me një aftësi të ndjeshme në zanatin e tij. Por ai mbetet gjithnjë modest. Në të gjitha vitet e emigrimit shqiptar, historitë e individëve janë të ndryshme, natyrisht kanë arsyet e veta, por përkushtimi i një profesionalisti të tillë, jashtë të gjithë atyre fateve dhe historive mbetet një model i papërshkueshëm, një fakt jetik, një fakt i gjallë, për të thënë me fjalë pambarim se ai meriton respektin më të madh, angazhimin e të gjithëve në respektim të një profesionalisti që gjithnjë ka qenë dhe mbetet shembull për shqiptarët dhe të tjerët që jetojnë e punojnë në këtë vend demokratik. Ndaj tingëllimet e BBC-së në fjalët e saj mediatike "He's an electrician by profession".

# DEKLARATË E RE E NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E IMIGRACIONIT

Punonjësit e kujdesit social mund të marrin viza për punëtorët e kualifikuar nga 15 shkurt 2022. Ndryshimi u njoftua fillimisht në prag të Krishtlindjeve dhe tani është konfirmuar në një deklaratë të ndryshimeve në Rregullat e Imigracionit (HC 1019), të publikuar dje. Punëdhënësit (por jo familjet private) do të jenë në gjendje të sponsorizojnë asistentët e kujdesit, kujdestarët në shtëpi, punëtorët mbështetës të shtëpive të pleqve dhe të ngjashme për sa kohë që ata paguajnë të paktën 20,480 £.

Për sa i përket historisë: shumë njerëz që bëjnë punën e përditshme jetësore dhe joglamuroze të kujdesit për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara janë nga jashtë. Para pandemisë, 16% e fuqisë punëtore të kujdesit social të rritur ishin shtetas të huaj, ndërsa pothuajse 40% e infermierëve të shtëpive të kujdesit të trajnuar jashtë vendit.

Profesionistët mjekësorë dhe punonjësit e kujdesit të lartë tashmë kualifikohen për atë që quhet viza e Shëndetit dhe Kujdesit, e cila ligjërisht është rruga e punëtorëve të kualifikuar me tarifa më të ulëta dhe përpunim më të shpejtë. Por kujdestarët e rregullt nuk konsideroheshin mjaftueshëm të aftë për t'u kualifikuar për viza sipas politikës së imigracionit pas Brexit.

Siç e thotë shënimi shpjegues që shoqëron HC 1019, "një kërkesë kryesore ekzistuese e rrugës së punëtorëve të kualifikuar është që oferta e punës duhet të jetë ajo që përfshin detyra dhe përgjegjësi që përfshijnë aftësi të barasvlershme me RQF të nivelit 3, gjerësisht ekuivalente me një nivel aftësish të marra nëpërmjet A. -nivelet ose të lartat skoceze". Puna e kujdesit kërkon aftësi dhe përkushtim, por nuk është ajo gjë që mësoni në nivelin A.

Home Office duket i vendosur të ruajë dallimin formal midis punës së kualifikuar dhe të pakualifikuar për qëllime vizash, edhe pse i lejon punonjësit e kujdesit në rrugën e punëtorëve të kualifikuar. Kjo çon në disa gjimnastikë ligjore. Punëtorët e kujdesit nuk po shtohen thjesht në listën e profesioneve të kualifikuara.

Rregullat e punëtorëve të kualifikuar do të ndryshohen më pas për të lejuar që njerëzit të sponsorizohen për role të pamjaftueshme që nuk janë profesione të aftë. Paragrafi SW 6.1 në Shtojcën Skilled Worker do të lexojë:

SW 6.1. Aplikanti duhet të sponsorizohet për një punë në një kod të kualifikuar profesioni të listuar në Shtojcën e Profesioneve të Aftësuara ose në Shtojcën Lista e Profesioneve të Mungesave.

Ky ka rezultatin e çuditshëm që kushdo që konsultohet me Profesionet e Aftësuara të Shtojcës pas 15 shkurtit do të vazhdojë të shohë punonjësit e kujdesit social të etiketuar në mënyrë eksplicite si të pakualifikuar për Punëtor të kualifikuar:

Tabela 5: Kodet e profesioneve që nuk janë të pranueshme për rrugët e punëtorëve të kualifikuar, transferimit brenda ndërmarrjes dhe praktikantëve të diplomuar brenda ndërmarrjes…

6145 Punëtorët e kujdesit dhe kujdestarët në shtëpi.

Megjithatë, nuk ka gjasa që dikush në sektorin e kujdesit social t'i gjejë të gjitha këto po aq interesante sa avokatët e imigracionit. Rezultati neto, duke gërmuar veten nga barërat e këqija, është se punonjësit e kujdesit social tani mund të aplikojnë për viza për sa kohë që paguhen 20,480 £ në vit dhe 10,10 £ në orë. Ato duhet të përfshijnë gjithashtu një certifikatë të dosjes kriminale (shih paragrafin SW 16.1).

Home Office thekson se kjo është vetëm "e përkohshme" për të "zbutur presionet aktuale në sistemin shëndetësor dhe të kujdesit social si rezultat i Covid-19". Do të ketë një dritare 12-mujore për aplikimet, pra nga 15 shkurt 2022 deri më 14 shkurt 2023, në të cilën pikë politika do të rishikohet. Nuk ka asnjë rëndësi ligjore për këtë: rregullat nuk skadojnë në shkurt 2023 dhe Home Office do të duhet të parashtrojë në mënyrë aktive një tjetër deklaratë ndryshimesh për të nxjerrë përsëri punonjësit e kujdesit.

Nuk do të ishte çudi nëse vizat e kujdesit social do të vazhdonin për një kohë të pacaktuar. Skema e lejimit të punëtorëve në bujqësi është ende, me shpresë, e referuar si një "pilot" pavarësisht se është në fuqi për tre vjet dhe duke u numëruar.

# TË PRIVOSH NJERËZIT NGA SHTETËSIA E TYRE DO TË THOTË T'U HEQËSH IDENTITETIN

Qindra njerëzve u është hequr shtetësia britanike në 15 vitet e fundit, sipas një studimi, duke përfshirë një burrë që ishte pa shtetësi për gati pesë vjet. Hulumtimi i kryer nga Free Movement, një faqe interneti e drejtuar nga avokatë për të ofruar informacion për ata që preken nga kontrolli i imigracionit, ka zbuluar se të paktën 464 personave u është hequr shtetësia që kur ligji që lejonte këtë praktikë u lehtësua 15 vjet më parë.

Qeveria nuk publikon në mënyrë rutinore numrin e përgjithshëm të njerëzve që i heq shtetësinë britanike. CJ McKinney, nga Lëvizja e Lirë, tha se mungesa e shifrave nga Zyra e Brendshme ishte zhgënjyese: "Ky është një dënim jashtëzakonisht i rëndë që në shumë raste përbën dëbimin nga MB. Të thuash se sa shpesh përdoren fuqitë ekzistuese për heqjen e shtetësisë është minimumi i transparencës që parlamenti dhe publiku duhet të presin."

McKinney zbuloi se që nga viti 2006, 175 personave u është hequr shtetësia për arsye të sigurisë kombëtare dhe 289 për shkak të mashtrimit. Para vitit 2006, kjo nuk ishte përdorur që nga viti 1973.

McKinney tha se ai e përpiloi informacionin nga kërkesat historike për lirinë e informacionit dhe "publikimet statistikore të errëta". Fuqia për t'i hequr dikujt nënshtetësinë britanike shkon në vitin 1914, por vitet e fundit testi ligjor se kur mund të përdoret është dobësuar. Ndërmjet viteve 2006 dhe 2010 ka pasur nëntë raste, sipas të dhënave të lirisë së informimit. Por deri në vitin 2017 shifrat kishin arritur kulmin në 148 persona të cilëve iu hoq shtetësia atë vit. Në vitin 2018 ka pasur 73 raste, në vitin 2019 82 raste dhe në vitin 2020 42 raste.

Një avokati, tha: "Të heqësh njerëzit nga shtetësia e tyre do të thotë t'u heqësh identitetin, ndjenjën e përkatësisë dhe aftësinë e tyre për të kërkuar mbrojtje. Si e tillë, në parim është e gabuar. Kjo padrejtësi shtohet vetëm kur kryhet pa ndonjë mbikëqyrje paraprake gjyqësore dhe bazuar në prova sekrete të cilat individi dhe avokatët e tij nuk do t'i shohin kurrë. Në vend që të forcojë më tej kompetencat e sekretarit të brendshëm duke hequr kërkesën për të dhënë njoftim, qeveria duhet të heqë plotësisht fuqinë e privimit."

Një zëdhënës i Home Office tha: "Home Office është e përkushtuar të publikojë raportin e saj të transparencës për përdorimin e fuqive përçarëse dhe do ta bëjë këtë në kohën e duhur. Heqja e shtetësisë britanike ka qenë e mundur për më shumë se një shekull dhe përdoret kundër atyre që kanë fituar nënshtetësinë me mashtrim, dhe kundër njerëzve më të rrezikshëm, si terroristët, ekstremistët dhe kriminelët e rëndë të organizuar."

Pra heqja e shtetësisë britanike të dikujt, e njohur edhe si heqja e shtetësisë, përdoret kundër atyre që kanë marrë shtetësinë me mashtrim dhe kundër njerëzve më të rrezikshëm, si terroristët, ekstremistët dhe kriminelët e rëndë të organizuar. Ajo gjithmonë vjen me të drejtën e apelit.

Por gjithnjë kini kujdes nga mashtruesit.

Faqja qeveritareju jep këshilla për t'u mbrojtur nga truket dhe mashtrimet për të cilat Home Office është në dijeni. Nëse merrni një email, telefonatë ose letër të papritur nga dikush që pretendon se është nga Home Office, mund të jetë një mashtrim. Ne kurrë nuk do t'ju kontaktojmë për të kërkuar para ose të dhënat tuaja personale. Kriminelët përpiqen t'ju bëjnë të besoni se mund t'ju ofrojnë diçka shumë lehtë, si për shembull një vizë për në MB, ose se ka një problem me aplikimin ose vizën tuaj.

Ata do të përpiqen ta bëjnë veten të duken shumë të vërtetë dhe mund të përdorin gjuhë që tingëllon zyrtare ose dokumente false, si p.sh. një letër oferte pune, sesa të duket e vërtetë. Ata tashmë mund të duket se dinë diçka për ju, si për shembull emrin dhe adresën tuaj, ose që keni aplikuar për vizë. Pastaj ju kërkojnë para ose informacione tuaja personale.

Nëse aplikoni për një të tillë, ju thonë se e keni vendin e punës dhe ju kërkojnë të paguani tarifat për vizë dhe leje pune. Sistemi ynë i vizave nuk funksionon kështu dhe nuk ka rrugë të shkurtra për një punë në MB. Një punëdhënës i vërtetë do t'ju drejtonte në këtë faqe interneti, ku mund të bëni një aplikim zyrtar. Nëse oferta e punës tingëllon shumë e mirë për të qenë e vërtetë, mund të jetë një mashtrim. Ne kurrë nuk do të garantojmë një punë në MB.

Një person që pretendon të jetë një oficer nga Home Office ose nga një qendër aplikimi për vizë. Ata mund të shkojnë në shtëpinë tuaj për të kërkuar para për të përpunuar vizën e partnerit tuaj. Oficerët legjitimë të vizave do t'ju takojnë vetëm në zyrat e tyre dhe nuk do t'ju kontaktojnë kurrë për t'ju kërkuar para personalisht ose me email ose telefon.

Ata mund të telefonojnë dhe t'ju thonë se ka një problem serioz me vizën tuaj. Ata kontaktojnë njerëz brenda Britanisë së Madhe dhe në vende të tjera, dhe shpesh synojnë studentët. Ato duken të vërteta dhe bindëse dhe mund të japin një emër të rremë dhe të kthejnë numrin e telefonit. Ata ju thonë të dërgoni para sa më shpejt të jetë e mundur duke përdorur metoda të ndryshme pagese si MoneyGram, për të parandaluar një lloj veprimi, si deportimi ose anulimi i vizës suaj.

# IKJA E DHIMBSHME E NJË NJERIU DUARARTË SI BASHKIM FASLLI SELIMAJ

Ndërsa kapërcente shkallën e fundit të ish-Ndërmarjes së Ujësjellësit në Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit, nga dritarja e zyrës, Drejtori i kësaj ndërrmarjeje, i paharruari dhe intelektuali mjaft i respektuar elbasanas, Rruzhdi Biza, e ndiqte me kërshëri udhën që përshkonte ai. E ndiqte dhe mendonte me vete, se tashmë ishte pikërisht Njeriu të cilin ai do ta kishte më afër se gjithë të tjerët, që kishte pasur më parë. „Është shoferi im!“ – i tha shefit të zyrës dhe sytë përsëri i ndali tek udha e Njeriut që ndiqte me kaq kureshtje. E pa dhe fshiu sytë. Ishte hera e parë që shihte një njeri, një shofer që të përkujdesej aq shumë për atë makinë, të bënte që ajo të mbetej si një pasqyrë ku mund ta shihje dhe veten. Ishte Bashkim Selimaj, djaloshi me aq zell dhe ullnet, ai që kishte një edukatë të trashëguar nga i ati, Faslliu dhe nga nëna e tij e dashur, Nazmija, po aq dhe nga fisi i tij i madh nga të anët, nga nëna dhe babai, të gjithë të respektuar.

Dhe ashtu me atë shikim drejtori tashmë ishte i bndur dhe bindja e shpurri deri në atë pikë, që sa herë që përmendej emri i Bashkim Faslli Selimajt, ai vetëm tundte kokën, miratonte dhe firmoste. Kështu ndodhi dhe në vitet që pasuan më tej, derisa ditën e lëvizjes demokratike nisën të ishin ndryshe. Kudo shkatërrohej, villej, përmbysej, vetëm atje ishte bindja se asgjë nuk ndodhte dhe asgjë nuk ndodhi se ai bashkë me vëllezërite tij u vunë në skalion dhe e mbrojtën sikurse të ishte prana e tyre private. Dhe kështu ndodhte gjithandej ku ishte ai, Bashkim Faslli Selimaj, Njeriu që me thonjë e ndërtoi familjen, pasi babai i ndërroi jetë herët dhe nëna ishte e lodhur nga hallet dhe dertet që kishte mbi kurriz. Në të gjitha punët dhe angazhimet ai mbeti punëmadh, duarartë, intelekt dhe mjaft aktiv.

E gjitha tek Bashkim Faslli Selimaj ishte një ndjesi njerëzore, respekti dhe dashurie deri në ekzistencë. Sa herë që ndjeje buzëqeshje dhe humor aty do të gjeje dikënd që të jepte shpresë, dashuri dhe gëzim, besim për jetën dhe familjen. Pra ishte e gjitha ekzistencë. Në ekzistencë?! Mendoj se të paktën disa prej nesh bien në këtë hulli menjëherë pa e ditur. Dhe koha ndërmjet asaj kohe dhe pikës kur ne e pranojmë atë me veten tonë, ka të bëjë më shumë me pranimin, qoftë social apo personal, se sa kohë duhet të marrë për të „arritur atje“, pikërisht në ekzistencë dhe mbijetesë! Kështu e gatoi dhe ai jetën në vitet e tranzicionit dhe më tej me biznesin e tij privat duke shitur materiale ndërtimi, ku gëzonte gjithnjë respekt nga klientët e tij. Ai ishte i dashuruar me të gjithë dhe të gjithë e donin atë. Ai mbeti i tillë dhe do të kujtohet gjithnjë si i tillë, vetëm me një emër të mirë: Bashkim Faslli Selimaj.

Si do ta shpjegonim ndryshe, nëse nuk do ta njohnim nga afër, të eshur, mik dhe fisnik, që gjithnjë ishte pothuajse e pamundur të mbahej mend një kohë ndryshe me të. Ndaj sot e gjithnjë gjërat më

të mëdha, kujtimet vërtet të mrekullueshme, ato nuk zhduken kurrë. Ne e gjejmë veten duke e parë këtë Njeri në ikjen e tij Hyjnore me mall, për ngushëllim, provë se kjo ndodhi, se dikur ishim me të, që të paktën për një kohë ndiheshim sikur i kishim të gjitha buzëqeshjet dhe urtitë e tij, të gjitha mirësitë që sjell dhe jep vetëm Njeriu. Dhe ne do të ndjejmë mungesën fizike të një Njeriu, por jo memrojen dhe kujtimin e tij, se ai, pra Bashkim Faslli Selimaj, edhe pse në një moshë relativisht të re, kur ende kishte ide dhe angazhime, na la një pikëdhimbje, pikëllim miku të mirë.

Dhe ne do ta kujtojmë atë. Janë ato momente që më bëjnë të pyes nëse ne me të vërtetë ndalojmë së kujtuari dikë. Pavarësisht se sa të ngarkuar ndihemi, sado që ndjejmë se na lodhin angazhimet, punët, hallet dhe arsyet e tjera, largësitë, thellë në vetvete, nëse jemi të sinqertë, të gjithë i kemi ato momente, edhe për ata që na mbesin në memorje më shumë. Sigurisht që mund të fshihen pas hidhërimit, të varrosur nën fajin „jetim“, të mbyllur pas mureve që ne e lejuam veten t'i ndërtojmë si një lloj mbrojtjeje, por ata janë ende atje. Ju jeni të gjithë ende atje, pas atyre dhimbjeve të ikjes, ikjes në amshim, ku shpirti juaj fluturon tashmë i lirë dhe ne në mungesë fizike hedhim një mori fjalish zemërmira memorjesh në vend të një grushti dhe në Dheun amë. Ngushëllime dhe shpirti i shkoftë në Parajsë Bashkim Faslli Selimaj, në Elbasanin që e lindi dhe rriti, aty ku ai u dashura përjetësisht.

# FALË INXINIERIT GËZIM ETHEMI, ATDHEU NË SYRIN TUAJ PËR TË DHJETAT E SEKONDËS

Atdheu, jo më kot thonë dhe mbetet realitet që është gjitnjë me vete. Kjo për shqiptarët e të gjitha trevave që jetojnë dhe punojnë në Britaninë e Madhe, është më se jetike, faktuale, dhe madje dhe shumë e ndërlidhur me tërë procesn e përditësisë. Një aparat i lidhjes televizive me stacionet e shumta anembanë Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë, tashmë është bërë prej kohësh një mënyrë që nuk mund të mënjanohet. Prindërit dhe të moshuarit e duan se natyrshëm kanë një pjesë të emocioneve aty, por dhe brezat e tjerë, të rrinjtë që ndjejnë lidhjen me atdheun dhe fëmijët që mbajnë më shumë mundësi kulturore, gjuhe, dhe me mundësi të tjera për të mësuar të gjitha që vijnë dhe transmetohen nga Atdheu. Dhe kështu ai është një domosdoshmëri, një mundësi për ta patur të gjithë. Dhe natyrshëm që të gjithë thuajse e kanë një lidhje të tillë. Por vetëm kaq? Kush interesohet dhe e bën atë më të sigurtë, më ligjore, më të ndjeshme në dorën dhe shtëpinë tuaj? Kush duhet tu gjendet shqiptarëve në të gjitha ditët e javës, në orë e pa orë për të fiksuar, mirëmbajtur dhe vënë në funksionin e një aparati sa ligjor dhe të sigurtë për shqiptarët?

### Specialisti i respektuar

Natyrisht ka një emër mes mjaft emrave të shumtë. Është mjeshtri, inxhinieri i satelitëve, Gëzim Ethemi, ai që me pak fjalë është njeriu i duhur, njeriu specialist që e bën akoma më të lehtë një lidhje të tilë, që të jep Atdheun për disa sekonda në sy. Dhe për këtë mjafton të dëgjosh fjalët dhe mirënjohjen e mjaft shqiptarëve anembanë Britanisë së Madhe, që flasin fjalët më të mira për të dhe tërë procesin e tij të këtij specilitetit të veçantë. Gëzim Ethemi, të thonë mjaft të tillë është njeriu më modest, më zemërmirë, i sjellshëm, i respektueshëm dhe natyrisht ka një njohuri të ndjeshme për këtë profesion, të cilin ka vite që e ushtron duke u dhën vetëm gëzim dhe hare klientëve të tij. Ai i njeh thuajse tashmë me majë të gishtave të gjitha lidhjet me anë të telekomukacionit.

Telekomunikacioni, që është transmetimi i informacionit në distanca të konsiderueshme për të komunikuar, është bërë prej kohësh edhe teori e praktikë për z Ethemi. Në të kaluarën, telekomunikacioni përfshinte përdorimin e sinjaleve vizuale, të tilla si fenerë, sinjale tymi, dhe heliograf optike, apo mesazhe audio nëpërmjet rënive të daulleve në mënyrë të koduar, dhe shembuj të tjerë të ngjajshme. Dhe ajo kohë natyrisht i kujtohet mjaft mirë z Ethemi dhe disa shqiptarëve të një moshe më të madhe. Në kohën moderne të energjisë elektrike dhe elektronikës, telekomunikacioni tani përfshin edhe përdorimin e pajisjeve elektrike të tilla si telegrafi, telefoni, dhe teleshkruesi, përdorimin e radio si dhe fibrat optikë dhe elektronika e tyre e lidhjes, plus përdorimin e satelitëve dhe Interneti. Kuptimet e hershme të komunikimit në largësi përfshinte sinjalet vizuele si zjarret sinjalizuese, sinjalet e tymit, sinjalet me flamuj dhe heliografet opetike.

### Njohuria dhe përkushtimi

Shembuj të tjerë para-modern të komunikimit në largësi të mëdha përfshijnë audio-mesazhet si kodimi i tingujve të daulles, brirët e mushkërive dhe bilbilat me zë të lartë. Teknologjitë modern për komunikim në largësi të mëdha zakonisht përfshijnë teknologjitë elektrike dhe elektromagnetikem si telegrafi, telefoni, dhe teleprinter, radioja, transmetimi i mikorvalëve, fibrat optike, dhe satelitët komunikues. Gëzim Ethemi, e di dhe e njeh mjaft mirë se një revolucion në komunikimin pa kabllo filloi në dekadën e parë të shekullit të 20 me zbulimin e komunikimit përmes radios nga Guglielmo Marconi, i cili e fitoi çmimin Nobel për fizikë në vitin 1909. Të tjera zbulime fillestare dhe zbulime në këtë fushë përfshijnë Charles Wheatstone dhe Samuel Morse (telegrafi), Alexander Graham Bell (telefoni), Edwin Armstrong, dhe Lee de Forest (radio), ashtu si dhe John Logie Baird dhe Philo Farnsworth (televizori). Dhe kështu ai shkon deri në njohuritë... *(vijon në faqen 13)*

*(vijon nga faqja 13)*

...e formësimit, ku vetë formësimi i një sinjali është dhe shërben për të përçuar informacion tek aparati i klientit në këtë rast.

### Përgjegjësia sociale dhe komunitare

Por ajo që e bënë akoma më të respektuar këtë specialist është përgjegjësia sociale dhe komunitare. Përgjegjësia Sociale është shumë e rëndësishme për z Gëzim Ethemi, po aq sa ajo komunitare. Ajo është pjesë e kulturës së tij prandaj dhe z Gëzim Ethemi ka një klientelë të gjerë dhe të sigurtë. Ai është një njeri me përgegjësi sociale, i vëmendshëm ndaj komunitetit ku jeton dhe vepron. Ndaj ai ka zgjedhur gjithnjë më ciloren, më të mirën, si 'bashkëpunëtorët' e tij në kuptimin figurativ, për të prurë gjithnjë gëzim dhe hare tek komuniteti dhe për të realizuar gjithnjë model dhe kulturë për tërë komunitetet dhe vendin në të cilin jetojmë.

### Familjar dhe angazhues i komunitetit

Gëzim Ethemi, kohët e fundit është dhe një kontributor i ndjeshëm ndaj tokës me efekt të kthimit të saj në një produkt bujqësor, për ta bërë atë të rrëndësishme, dhe këtë e bën ai në një kopësht në patronazh, gjithnjë në kohën e tij të lirë. Dhe atje ka rezultate të mira, dhe pse është në fillim, duke marë shembull nga mjeshtri këtij profesioni, agronomi i talentuar Përparim Muça, por dhe tek fëmijët, djalin e ka një talent që premton në futboll, dhe kështu dhe fëmijët në përgjithësi i ka modele në edukim, por kjo është një temë tjetër që do ta trajtojmë një herë tjetër. Mos harrojmë ai është dhe një aktivist i shkëlqyer i komunitetit dhe një familjar model që nuk harron të uroj dhe bashkëshorten e të respektoj traditën me fëmijët.

# KONKLUZION

Vetëm para disa kohësh Gëzimi ishte një nga të parët që e kaloi me sukses Covid-19. Ai qëndroi në spital me një përkujdesje të mjekëve, por gjithnjë ishte në shërbim të klientëve të tij. Ai asnjëherë nuk e ka neglizhuar klientin e tij. Edhe në situatën e ngarkuar pandemike, Gëzim Ethemi ishte një nga komunitarët që shërbeu me vrullin më të madh dhe me përkushtimin e dedikuar nga komunitetit.

Si i tillë, Gëzim Ethemi, gjithnjë. Emë shumë gëzon respektin e komunitetit, miqve dhe shokëve të tij, dhe kështu ai mbetet njeriu më aktiv dhe më i angazhuar në shërbimin e tij, me qëllim qqë në sy të shqiptarëve të sjellë sa më pastër e më mirë Atdheun, atë që ndoh atje, atë që duhet të jetë gjithnjë me qëllim që fëmijët dhe brezat që rriten në MB të mos e harrojnë origjinën e tyre.

# KOSOVA NË VITIN 2022

Katërmbëdhjetë vjet më parë, më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli zyrtarisht pavarësinë. Serbia, e mbështetur nga Rusia, e quajti deklaratën të paligjshme. Serbët që jetojnë në Kosovë në masë të madhe e kundërshtuan gjithashtu pavarësinë e Kosovës; ata shpejt zgjodhën asamblenë e tyre si një sfidë e drejtpërdrejtë ndaj kushtetutës së re të Kosovës, e cila hyri në fuqi në qershor. Kështu shqiptarët anembanë do të festojnë këtë vit afrimin e një dekade e gjysëm pavarësi në këtë pjesë shqiptare të shkëputur padrejtësisht nga shekujt mizorë. Por Kosova edhe pas këtyre katëmbëdhjetë viteve ka problemet e saj dhe faktet që dëshmojnë të mirën e një arsyeje që tashmë mbetet analizave.

Opinionisti dhe studiuesi Nuhi Shala nga „KALLXO“ është ndalur në një pikëpamje për Kosovën e vitit 2022. ai shkruan në një artikull të gjatë se „ Pas ardhjes në pushtet të partisë së majtë 'Vetëvendosje' e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti në mars të vitit 2021, duke korrur një fitore të madhe zgjedhore, kjo parti pësoi një humbje të madhe në zgjedhjet lokale të mbajtura në muajin tetor të vitit 2021, gjë që bëri që opozita të kërkonte zgjedhje të parakohshme.“

Zoti Shala detajon se „Humbja e pësuar në zgjedhjet lokale e ka dobësuar pozicionin e Kurtit. Vetëvendosje fitoi vetëm katër komuna nga 38 sosh, prej të cilave dhjetë janë të rezervuara për serbët etnikë në Kosovë. Shumica e kryetarëve të komunave janë zgjedhur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Lista Serbe fitoi dhjetë pozita për kryetar komune. Kandidati i Vetëvendosjes për kryetar të Prishtinës, Arben Vitia, nuk arriti ta fitojë raundin e dytë të zgjedhjeve pasi votuesit zgjodhën Përparim Ramën nga partia opozitare, LDK, shkruan bne Intellineës.“

Analiza shkon më tej dhe natyrisht duke marë shkas prej saj dhe duke mos dashur ta lodhim lexuesin shtojmë se „Megjithatë, pas disa viteve të paqëndrueshmërisë politike, agjencia amerikane e vlerësimit të kredisë, Fitch Ratings Inc., pret që situata politike në Kosovë të përmirësohet në vitin 2022, pasi Vetëvendosje ende gëzon një mandat të fortë nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021. Parashikimi pasqyron gjithashtu një përmirësim të pritshëm të situatës së COVID-19 në Kosovë dhe rritje të vazhdueshme ekonomike, pasi programi i vaksinimit vendas ndihmon në parandalimin e përhapjes së mëtejmë të virusit.“

Dhe vijmë tek thelbi i shkrimit të autorit të lartcituar se „Kosova tani ka shkallën më të lartë të vaksinimit në Ballkanin Perëndimor. Kosova ishte vendi i fundit në Ballkanin Perëndimor që filloi aplikimin e saj të vaksinimit, por ajo shënoi progres të shpejtë dhe e mbylli vitin 2021 me një numër të ulët ditor të infeksioneve të reja nën 10 sosh. Ndërkohë që është rritur që nga mesi i janarit, Kosova kishte numrin më të ulët ditor të rasteve të shfaqura në rajon.Sa i përket politikës së jashtme, Kosova po përballet me një vit në të cilin arritja e një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga BE-ja me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve me Beogradin do të jetë sërish fokusi politik.“

Duhet theksuar sipas autorit se „Pas ardhjes së Kurtit në pushtet, bisedimet me Serbinë ngecën dhe marrëdhëniet u përkeqësuan, pasi qeveria e Kurtit rivendosi disa masa reciprociteti ndaj Serbisë.Komisioneri i lartë i BE-së, Josep Borrell, ka thënë se themelimi i

Asociacionit të Komunave Serbe për të cilin pala serbe këmbëngul se është pjesë e marrëveshjeve të Brukselit, duhet të implementohet nga pala kosovare.Kosova e ka shpallur pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, por ende nuk është njohur nga Beogradi si shtet më vete. Po ashtu edhe pesë vende anëtare të BE-së nuk e njohin Kosovën. Kjo në mënyrë efektive pengon progresin e saj drejt anëtarësimit në BE derisa të arrihet një zgjidhje me Serbinë, e cila tashmë është në proces të negociatave të anëtarësimit në BE.Në muajin dhjetor 2021, Kosova e informoi Këshillin e Stabilizim Asociimit të BE-së (Këshilli SA) për synimin e saj për të aplikuar për anëtarësim në BE, porse fillimisht duhet të normalizuar marrëdhëniet e saj me Beogradin.Anëtarët e Këshillit të Stabilizim Asociimit u pajtuan për nevojën që Kosova të vazhdojë me reformat dhe për fokus të shtuar nga të gjithë aktorët politikë, fuqizimin e kapaciteteve administrative dhe një strukturë efektive koordinuese brenda institucioneve të Kosovës dhe ritheksuan rëndësinë e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.“

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në forcimin e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe respektimin e të drejtave themelore, si dhe për të vazhduar reformën e administratës publike dhe zhvillimin ekonomik, si dhe mbështetjen e arsimit dhe punësimit.Do ketë edhe përballje me problem pasi Ministrja e Drejtësisë Albulena Haxhiu deklaroi në muajin janar se Prishtina do të vazhdojë me verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të vendit (vetingun) pavarësisht kundërshtimeve nga BE-ja. Zyrtarët e BE-së e kanë dekurajuar Kosovën nga ndjekja e reformave në drejtësi sipas formatit të përdorur në Shqipëri, i cili, argumentuan ata, mund të çojë në kaq shumë shkarkime e ku pastaj gjykatat dhe prokuroritë mund të bëhen jofunksionale.Gjyqi i parë për krimet e pretenduara të luftës të kryera nga ish-Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) gjatë luftës për pavarësi ndaj Serbisë në vitet 1998-99 filloi në Hagë më 15 shtator 2021, me ish-pjesëtarin e UÇK-së, Sali Mustafa të ulur në bankën e të akuzuarve.

Gjyqi kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarit Kadri Veseli, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të cilët u dërguan në Hagë në nëntor të vitit 2020, pritet të vazhdojë edhe në vitin 2022 nga Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Prokuroria e Specializuar.Nuk përjashtohet mundësia e protestave në mbështetje të Thaçit kur të nisë procesi gjyqësor kundër tij.Thaçi është akuzuar për krime lufte të kryera gjatë kohës sa ishte pjesëtar i lartë i UÇK-së. Ai dha dorëheqjen më 5 nëntor të vitit 2020 dhe u zëvendësua nga Vjosa Osmani, e cila zyrtarisht mori detyrën e presidentes së vendit në prill të vitit 2021.

# PËRÇARJA E DEMOKRATËVE VAZHDON EDHE NË BRITANINË E MADHE

Përçarja e demokratëve vazhdon edhe në Britaninë e Madhe. Themi kështu pasi tashmë kemi të bëjmë edhe në mesin e komunitetit shqiptar të Britanisë së Madhe, thuajse dy grupe që gjashëm me atë që ndodh në Shqipëri të përkrahin PD-në e drejtuar nga z Lulzim Basha dhe PD-në që ka krijuar Komisioni i Rithemelimit të PD-së, të ujdëhequr nga Prof Dr Sali Berisha. Po ku e mbështesim këtë fakt?

Një komunikatë e shpërndarë për mediat nga Sekretari i Degës së PD-së në Britaninë e madhe, Shkëlzen Rustemaj, dhe që është publikuar online në disa media tregon se „Anëtarët e degës së PD-së, në Britaninë e Madhe kanë shkarkur kryetarin e kësaj dege të PD-së“, avokatin e emigracionit dhe drejtor i Kompanisë së vetme avokatore shqiptare në BM, Naim Hasanin.

Sipas komunikatës së anëtarëve shkarkimi ka ardhur pas veprimeve të Hasanit i cili sipas tyre vetë kishte ndarë rrugët me një pjesë të kryesisë së degës. Thuhet sipas kësaj komunikate, se shkarkimi i tij u votua në mënyrë unanime nga 9 anëtarët që kanë qenë prezent në takim. Edhe pse kjo komunikatë shtë botuar online dhe ne e kemi pamrë nga rrjett online, e bëjmë të mundësuar për lexuesit tanë të pltë.

Njoftimi i plotë:

„Duke parë zhvillimet e fundit brenda Partisë Demokratike dhe me kërkesë te pjesës më të madhe të anëtareve, mblidhet Kryesia e PD-së Dega Britani e Madhe. Një pjesë e anëtarëve ngrenë shqetësimin, pasi kishte kohë ku Kryetari i Degës i kishte bllokuar në rrjetet sociale dhe pikërisht në FB. Duke parë që vetë Kryetari e kishte ndarë rrugën politike, me pjesën më të madhe të anëtarëve të kryesisë, nuk kishte mbetur asgjë tjetër vetëm ana formale për shkarkimin e tij dhe si rrjedhojë sot me Dt.16/01/2022, në mënyrë unanime u votua për përjashtimin e z. Naim Hasanit si Kryetar i Degës së PD-së nMbretëri e Bashkuar. -Kryesia përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët sipas prezencës kanë njoftuar për të përjashtuar Kryetarin.“

Bazuar në këtë komunikatë thuhet se në mbledhjen e organizuar me këtë qëllim kanë qenë të pranishëm nëntë anëtarë. Dhe ata 9 anëtarë që kanë qenë prezentë janë si më poshtë:

Shkelzen Rustemaj; Enkeled Omi; Arjan Borufi; Lutfi Vata; Davida Deda; Shkëlqim Plisi; Sokol Ndosha; Jeta Muslija Rustemaj dhe Sadri Lushaj. Në komunikatën e botuar thuhet se një anëtar për arsye shëndetësore ka qenë online dhe ai është Imanuel Caushi.

Po në këtë komunikatë thuhet se 3 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, dhe ata janë Gazmend Cufaj, Leda Bona, Halil Kabashi. Njëkohësisht thuhet se 2 anëtarë kanë dhënë dorëheqjen dhe ata janë Elenica Mishto dhe Përparim Pavdeja. Komunikata është nënshkruar nga Kryesia e Degës PD Britani e Madhe dhe konkretisht nga Sekretar Organizativ i Degës së PD-së në Britaninë e Madhe, z. Shkëlzen Rustemaj.

Në anën tjetër nëpërmjet telefonit ne kontaktuam avokatin Naim Hasani dhe natyrisht brenda mundësive telefonike kërkuam arsyet dhe mundësinë e një shpjegimi. Z hasani na u shpreh se ai është i angazhuar të vazhdojë punën e tij dhe angazhimi i tij për Demokracinë nuk do të nfdalet se ai i përket ashtu sikurse ka theksuar të ardhmes dhe Shqipërisë për një të ardhme. Ai thekson se mbështet me të gjitha mundësitë e tij Kryetarin e PD-së Lulzim Basha.

# LIGJ I RI: NUK DO TË KENI MË NEVOJË TË FAJËSONI PARTNERIN

Nuk do të keni më nevojë të fajësoni partnerin nëse dëshironi një divorc

Një ligj i shumëpritur divorci hyn në fuqi më 6 prill 2022, që do të thotë se çiftet e martuara që duan divorc nuk do të duhet të fajësojnë askënd për prishjen e marrëdhënies. Sipas legjislacionit aktual, çiftet e martuara dhe çiftet në partneritet civil mund të aplikojnë për divorc vetëm nëse mund të provojnë në gjykatë se martesa e tyre është prishur në mënyrë të pakthyeshme dhe si rezultat i një prej veprimeve të çiftit në një ose më shumë nga tre faktorët vendimtarë: tradhtia bashkëshortore, sjellje të paarsyeshme ose dezertim.

Përndryshe, nëse të dyja palët duan një divorc, por nuk mund të provojnë një nga faktorët, duhet të ndahen për dy vjet përpara se të aplikojnë për divorc, ose për pesë vjet nëse vetëm njëri partner dëshiron divorcin.

Por kur ligji i ri të hyjë në fuqi, çiftet nuk do të duhet më të dëshmojnë se partneri i tyre ishte fajtor për prishjen e martesës së tyre. Dhe ndërsa aktualisht vetëm një partner mund të aplikojë për divorc, ligji i ri do t'i lejojë të dy partnerët të aplikojnë për divorc së bashku nëse dëshirojnë.

Pra, Akti i divorcit, shpërbërjes dhe ndarjes 2020, i cili do të lejojë çiftet e martuara të divorcohen pa fajësuar, do të hyjë në fuqi më 6 prill 2022. Kim Fellowes, bashkëthemelues i Silk Family Law dhe ish-kryetar i Komitetit për Mbështetjen e Fëmijëve të Rezolutës, i cili loboi në parlament për këtë çështje, tha: "Si avokatë të familjes ne mirëpresim këtë legjislacion të shumëpritur, i cili do të reduktojë konfliktin gjatë divorceve dhe në mënyrë thelbësore do të thotë që fëmijët të mos detyrohen të "zgjidhin anët". Familjet e ndara duhet të punojnë së bashku për shumë vite pasi divorci të jetë finalizuar, veçanërisht kur fëmijët janë të vegjël.

Heqja e "lojës së fajit" do t'u mundësojë prindërve të kenë një marrëdhënie shumë më të mirë pune me njëri-tjetrin duke ecur përpara.

Nigel Shepherd, ish-Kryetari i Rezolutës i cili udhëhoqi thirrjen për Divorcin pa faj për shumë vite, tha: "Megjithëse çdo vonesë është zhgënjyese, ne deri tani kemi siguri për prezantimin e kësaj reforme të rëndësishme dhe do të jemi në gjendje t'i këshillojmë klientët në përputhje me rrethanat. Përvoja e anëtarëve tanë në përdorimin e formularëve dhe proceseve në internet nuk ka qenë universalisht pozitive, dhe prandaj është thelbësore që IT të jetë e përshtatshme për qëllimin në mënyrë që të sigurohet që procesi i ri i divorcit të funksionojë ashtu siç synohet. Vonesa do të lejojë gjithashtu praktikuesit të njihen me rregullat e reja në kohën e duhur përpara se ligji të hyjë në fuqi.

Rezoluta u themelua në vitet 1980 nga një grup avokatësh familjarë të cilët besonin se një qasje jokonfrontuese ndaj çështjeve të së drejtës familjare do të prodhonte rezultate më të mira për ndarjen e familjeve dhe fëmijëve të tyre. Anëtarët e akredituar nënshkruajnë një Kod Praktike, duke u angazhuar për të punuar me familjet në një mënyrë konstruktive që redukton konfliktin.

# RONELA HAJATI E NIS NGA LONDRA

Ronela Hajati, e njohur ndryshe si Ronela, është një këngëtare, kantautore dhe kërcimtare shqiptare, që si fituese e këngës në festivalin. Efundit në RTSh shqiptar, i nisi përgatitjet seriozisht për të dalë sa më mirë në Eurovision nga Londra. E lindur dhe e rritur në Tiranë, ajo filloi të performonte në konkurse të ndryshme kënge dhe vallëzimi që në fëmijëri përpara se të ndiqte karrierën në muzikë. Hajati shquhet për shkathtësinë e saj në muzikë, stil dhe interpretim. Kështu ajo erdhi në Londër, ku u shfaq me disa fotografi në rrjetet sociale duke nënkuptuar se një kompani mjaft serioze që dikur kishte plane të tjera tashmë e ka marë në konsideratë përgatitjen e saj sa më serioze.

Pra tashmë kur dihet se Ronela Hajati do të përfaqësojë Shqipërinë', pas asaj që shpalli "Festivali i 60-të i Këngës" në një përfundim dramatik pas tre netësh konkurrimi, ajo pra do të jetë përfaqësuese e Shqipërisë në Torino në Eurovizon! Ronela Hajati ishte së fundmi në Londrër për të përpunuar këngën e saj "Sekret" me të cilën do marrë pjesë në Eurovision. Ashtu siç kishte premtuar, këngëtarja ka ndarë me ndjekësit momente nga regjistrimi i këngës. Ajo ka zbuluar se ishte në Sarms Studios dhe po punonte me producentin Diztortion. Ajo ndau dhe një video dhe disa fotografi me këtë rast. Mediat raportuan se Ronela Hajati çmimin e parë ia dedikoi të atit që nuk jeton më dhe pavarësisht se shumica e publikut e përkrahte si fituese, ashtu si çdo vit, edhe kësaj radhe kishte kundërshtime.

Ronela Hajati, është e bija e gazetarit të njohur dhe autori Marash Hajati. I Ati i saj ka qenë drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit si dhe kryeredaktor i gaztës „Zëri i Popullit" dekadën e fundit të regjimit komunist. Marash Hajati u lind më 10 janar 1934 në Shkodër, në lagjen e malësorëve siç quhej asokohe, i biri i Kolës dhe Sofijes. Shkollën e mesme e kreu më 1952 në qytetin e lindjes. Nga viti 1952 e deri në vitin 1957 ndoqi studimet e larta e në Universitetin e Petërburgut, në Fakultetin e Filologjisë, dega gazetari. U caktua si redaktor në gazetën "Puna" e më pas, sekretar kolegjumi i saj dhe instruktor për shtypin. Nga viti 1974 deri në vitin 1988 ka qenë fillimisht Drejtor i Televizionit e që nga fillimet e viteve 80-të Drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit. Në vitet 1988-90 Kryeredaktor i gazetës "Zëri i Popullit". Për afro 14 vjet ka qenë Kryetar i Bashkimit të Gazetarëve të Shqipërisë, ku zëvendës i tij ishte një emër dhe një figurë tjetër e shtypit të asaj kohe, Mefail Pupuleku. I Ati i Këngëtares, Hajati, vitet e fundit ishte dhe kryetar i shoqatës së Nikajt e Mërturi, dhe kryeredaktori i parë i gazetës që doli nga kjo shoqatë, po me emrin Nikaj i Mertur. Marash Hajati ka qenë i nderuar me Çmimin e Republikës dhe është autor i disa botimve si Bijtë e tokës sime (krijime publicistike), 1982;

Dera e prapme shtypit, (ngjarje e kujtime nga puna në shtyp e media), 1998; Shqipëria në kapërcimin e shekullit, (analiza e komente). 1999; Çanta me kontratë, (Poezi); Tish Daija, i veçanti, (monografi), 2005; Vite befasish. (kujtime); Histori dhe Vizion Stefani & Co, (monografi); Dritëro, kohës i falemi për këtë ditar (kujtime), 2012.

# SUKSESI I „BIG BOSS SERVICES UK LTD“ NË BASHKËSI SIPAS LIGJEVE BRITANIKE

Kostot materiale dhe çështjet e punës goditën sektorin e ndërtimit dhe shërbimeve të tilla në vitin 2021, por, pavarësisht kësaj, fusha të caktuara të industrisë po lulëzojnë. Ndërsa disa punë janë ngadalësuar nga politika, të tjera janë nisur nga vendimet e duhura politike. Këtu janë në fakt ndryshe me syrin e Gazmend Cufaj, drejtuesit të Kompanisë „Big Boss Services UK Ltd“ ku projektet që industria është përqëndruar janë tashmë një mundësi e re, edhe pse në kushte të tjera. Projektet e tilla që kanë filluar me objeksione të reja, si lëmimi i dërrasave dhe llakut të dyshemesë në Harringay London, në kohën kur të tjerët duhet të kishin arsyen e procesit, trajnimit, apo specialistëve, kur në të njëtën kohë në këtë kompani gjithnjë specialisti është më afër se sa mendohet.

Unë do të doja që komania jonë të vazhdojë të vendoset si një forcë për të mirë të suksesit në vazhdim këtë vit. Modeli ynë për „Big Boss Services UK Ltd“, ai që ka një pamje afatgjatë dhe përqafon mjedisin dhe vlerën shoqërore, bazohet në besimin tonë se ne mund të kemi një ndikim pozitiv në vend, qytete dhe komunitete, ndërkohë që kemi një mendje komerciale.

Qëndrueshmëria është padyshim një pjesë e madhe e këtyre synimeve. Pas mjaft projekteve qëmbyllëm me sukses, atyre që bvazhdojmë në mënyrën më të mirë, duket sikur jemi të fokusuar në veprime kuptimplota për herë të parë dhe se klientët kanë filluar t’i kushtojnë vëmendje. Për të ndërtuar mbi atë momentum këtë vit, tani duhet të zhvillojmë një grup të standardizuar përkufizimesh dhe metrikash për

të mbështetur udhëtimin tonë kolektiv drejt zeros neto.

Bizneset aktualisht kanë një detyrë të pamundur në zhbërjen e udhëzimeve të ndryshme dhe angazhimeve të pafundme të uljen së karbonit. Ka ËorldGBC, OKB, Iniciativa e Transformimit të Energjisë në Londër dhe Objektivat e Bazuar në Shkencë, për të përmendur vetëm disa, por ne jemi gjithnjë në afërsi të kërkesave qeveritare, pasi kemi marë të gjitha masat që të realizojmë me sukses dhe të ulim përqindjen e karbonit në ajër.

„Big Boss Services UK Ltd“ mendojmë se ka nevojë për një kornizë të qëndrueshme që përfshin gjithçka: karbonin operacional dhe të mishëruar - historikun, të tashmen dhe të ardhmen. Nëse mund të identifikojmë një mënyrë universale për të matur ndikimin dhe përparimin, atëherë dhe ne „Big Boss Services UK Ltd“ mund të punojmë së bashku me më të mirët, të ndajmë njohuritë dhe praktikat më të mira dhe të sigurojmë që të gjithë të kalojmë vijën e finishit përpara vitit 2050.

# DY SKICA

## 1. Shpinëkthyer

Çdo mëngjes para se të lajë sytë kthehem shkitazi tek pasqyra. E ndjej sikur shoh dualitet. Ndjej…, ndjek, dhe përcjell atë që syri e fleks. Syri, si një nga shqisat e ndjeshme kërkon tinës, edhe përtej shpinës. Shpina mbetet një kthinëz, aty ku formohet e përkryer, forca e postulatit shpinëkthyer. E kjo është e vërteta: Shpinëkthyer si vetë jeta.

Çdo natë kur kthehem nga puna, para se të bie në gjumë, pres të pyes veten, nëse nuk ndodh të pyetem, habitem, vërtitem të gjej arsyen, pse. Pse ndodh kështu me mua, me ty, me të gjithë ne?

Pres të më pyesin, të më pyesësh, me qëllim që të kuptohem me „pse"-në, që të shpjegoj me të vërtetë „pse"-të.

Mund të shpjegoj. Mund të shpjegohem. Ndjej të shpjegohem: pse? Pse ndodhi të jetë kjo e ndodhur me shpinëkthyer. Shpinëkthyer?!

Shpinëkthyer, se nëse kthehem përmbys, nuk mund të të shoh. Nëse kthehem dhe zgjohem natën, gjë që duket se ndodh çdo natë që qëndroj syhapur, të paktën dy ose tre herë, atëherë gjithçka që shoh në dritën e hënës është dera e papafingos, skica e paqartë e një tavoline pranë shtratit, shkëlqimi i butë pulsues i një celulari që po ngarkon trurin e vet dixhital dhe elektronik. Sepse, është pse, pse është sepse dhe nëse nuk mund të të shoh, atëherë mund të bind veten se nuk do të ndjej nevojën të të prek.

Sepse nëse nuk të prek, nuk kam pse të merrem me mënyrën se si ndihesh kur tërhiqesh në këtë hendek.

Kështu që unë kthehem çdo natë para se të fle dhe pres që ju të pyesni „pse", pra pse ndodh kështu me ne?.

Por ju kurrë nuk e bëni. Nuk e bëni dhe kur keni mijëra minuta kontrate në celularin tuaj për tu konsumuar. E kur ndodh, që të cingërroni, natyrisht, fatmirësisht e kuptoj se diçka është rikthyer, përpara një pasqyrimi të kësaj pasqyre shpinëkthyer.

Dhe them kushedi çfarë halli i ka rënë, kushedi çfarë derti e ka përlyer këtë termin shpinëkthyer, që na u bë shpinëthyer në sytë e dukshëm e të padukshëm!

## 2. Funerali

Sot ka një funeral matanë rrugës. Pavarësisht temperaturave të ulëta dhe stuhisë së afërt, parkingu i makinave është plot. Miqtë dhe familja mbushin kishën për t'i thënë lamtumirën e fundit të dashurit të tyre të humbur. Në fund bien zilet, bien fort këmbanat e kishës. Garda e nderit e veteranëve del jashtë dhe rreshtohet pas makinës së varrimit, duke përshëndetur kur nxirret arkivoli.

Nuk pushon kurrë së më bëri të mendoj se si ajo kuti e vogël prej druri është më e vogël nga sa do ta prisnit të ishte. Asnjëherë nuk duket mjaft e madhe. Unë gjithmonë shikoj arkivolet dhe mendoj: „Jam i sigurt se ai ishte më i gjatë se kaq. Ai, apo Ajo ishin më të mëdhenj se sa janë aty në aty kutizë".

Por mospërputhja e vërtetë nuk është në shtatin e njeriut në krahasim me madhësinë e arkivolit, por në jetën e atij që mbahet brenda tij.

Vërtet vjen deri te kjo?

Jeta e dashurisë dhe aventurave të një njeriu, më shumë se shumica duke gjykuar nga roja e nderit, mosha mesatare dhe numri i vajtuesve. A ka të bëjë gjithçka me kutinë prej druri që duket shumë e vogël?

Por më pas kuptoj diçka që nuk e kisha menduar derisa u ula për ta shkruar këtë.

Masa e këtij njeriu, masa e jetës së tij, nuk mund të gjendet në atë kuti dhe as të pasqyrohet nga madhësia e saj. Jeta e tij mund të matet me ata që erdhën për të thënë lamtumirë. Nga pikëllimi në fytyrat e tyre për humbjen e shokut të tyre. Nga garda e nderit, duke qëndruar krenarë, të drejtë dhe më të fortë se vitet e tyre, për të përcjellë shokun e tyre nga kjo botë në tjetrën.

Dhe ndërsa e ftohta shtohen dhe një vesë e hollë fillon të bjerë, nuk mund të mos mendoj, kush do të jetë atje për të matur jetën e Njeriut që ta shohin të gjithë?

# ARKIVAVE BRITANIKE: TË PANJOHURA

Në vitet tetëdhjetë hyn në Shqipëri nga zona e Malit të Zi, nëpërmjet një marrëveshjeje turistiko-kulturore të ish-Jugosllavisë dhe Francës, disa dhjetëra britanikë me pasaporta franceze. Arsyet ishin se francezët kishin më shumë lehtësi në Shqipërinë e asaj kohe dhe se britanikët shikoheshin si mjaft të dyshimtë. Në një material arkivor që daton me Janarin e vitit 1983 shkruhet pak a shumë se në Elbasan „vetëm shëtitorja është një lëvizje e masës, pa drejtues, edhe drama politike shqiptare shpaloset në një skenë pa yje."

Vizitorët britanikë të paisur me pasporta franceze e të vendosur në Hotel „Skampa" në Elbasan e ndjenin ndryshesën dhe nga literatura që shitej në Librari dhe nga ajo që mbahej në Bibliotekën lokale. Ata ishin të edukuar mirë, natyrisht dhe të interesuar për Shqipërinë, madje disa pjej tyre dinin dhe kishin mësuar shqip me dy ish-gazetarë të BBC-së, dhe natyrshëm ishin mësuar në ditët e qëndrimit të tyre të lexonin ndonë roman, novelë, apo dhe më tej.

Kur nuk gjenin atë që dëshironin ja se si ata shkruanin: „Ne jemi afër shpirtit të Quilp, Uriah Heep dhe Scrooge këtu, sepse si në romanet e Dickens, Copperfields dhe Tëists të Shqipërisë fitojnë gjithmonë. Dallimi është se në aspektin letrar kanë kaluar njëqind vjet dhe melodrama viktoriane nuk duhet të jetë askund në rritje. Jemi rritur me humanizmin e Faulkner-it, Kafkës, Pasternakut, Camus-it, Joyce-it dhe Gabriel Garsia Marquez-it, por asnjëri prej tyre nuk gjendet në libraritë shqiptare. Gorki është ende i disponueshëm në përkthim, dhe dramat e Shekspirit tani konsiderohen 'të sigurta', por shkrimtarët e tjerë të mëdhenj të botës, nga Sofokliu, Terenca dhe Dostojevski, fatkeqësisht mungojnë."

Shqipëria, shkruanin ata, është mes hijes së krijuar prej Bashkimit Sovjetik dhe regjencës së tretur të Kinës në një periudhë kohe të ndjeshme. Literatura është ajo që bën dallim dhe që të bën të kuptosh se ka verdikt të dyzuar.

2. Kostumet: Identitet i pastër Shqipërie

Në një botim të vitit 1842 thuhet se "kostumet e shqiptarëve janë shumë piktoreske". Mbi këtë bazë u realizuan litografitë me ngjyra të piktorit Xhozef Kartrait. Disa prej tyre janë në albumin "Kostume të zgjedhura nga Shqipëria dhe Greqia" që është botuar në Londër në vitin 1922. Uilliams pas dy udhëtimeve të viteve 1819 dhe 1824 nxjerr në pah figurën e një luftëtari shqiptar me kostum kombëtar. Pastaj shkojmë tek Kokreli, Alan, Gell, Barret, Liri, Durham, çifti anglez Zhan dhe Kora Gordon që solli 100 vizatime, grafika e punime midis të cilave spikasin kostumet shqiptare.

Më vonë janë francezët që zgjerojnë dashuritë e tyre me kostumet shqiptare. Deka realizoi "Valltaret shqiptare", "Gratë suliote"; Shefer u përqëndrua tek "Shqiptarja" dhe Koro tek "Haideja" etj. Zheromi ekspozoi bukurinë e kostumeve shqiptare në Paris, Londër, Nju Jork etj. I zbukuruar me këtë madhështi kostumi shqiptar paraqitet në krijimet e shumta të Keton Utvilit.

Piktori zvicerian Sharl Gler dhe ai kroat Jovanoviç shpallin miqësinë që kanë pasur me Kolë Idromenon dhe natyrshëm spikasin me kostumet shqiptare. Këto e jaft gjëra janë jo thjesht përtej heshtjes, por vetë filozofia e veshjes. "Filozofia e veshjes" është një ese nga Oscar Uilde që u shfaq në The New York Tribune në 1885. Vetë kjo ese mbeti e panjohur për shkollarët deri në vitin 2012. Arsyet?! Ndërsa fshihen dihet se ajo u rizbulua dhe u botua për herë të parë në formë libri nga historiani Uilde John Cooper në Oscar Uilde On Dress (CSM Press, 2013). Për kostumet shqiptare ka mjaft botime, fakte dhe realizime artistike. Kaq dihet. Nuk e di a ka fonde Ministria e Kulturës të realizonte atë që ende mungon? Jo thjesht për hir të kësaj filozofie. Jo! Por për atë që është nder, krenari, vlerë, identitet i pastër Shqipërie.

# QYTETI I PEJËS QË NGA VITIT 1851 E DERI 1999

*Nga Hasan Hasanramaj*

Qytete dhe fshatrat e Rrafshi i Dukagjinit paraqesin një burim të begatshëm të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të periudhave të ndryshme historike, të cilat veçohen për nga vlerat, cilësitë, karakteristikat me rëndësi të madhe. Zbulimet arkeologjike në arealin e tyre tregojnë se në këtë hapësirë është i pranishëm procesi i organizuar i jetës urbane qysh nga kohërat më të hershme. Është interesant të përcillet ndërrimi i influencave të ndryshme të etnokulturave në vendbanimeve të Rrafshit të Dukagjinit prej godinave dardane, romake, bizantine, sllave dhe turko-orientale. Kështu me të gjitha vlerat kulturore popullore shqiptare si arkitektura, skulptura, doket dhe zakonet e trashëguara nga koha antike e Bizantit dhe në mesjetë nga osmanët, kohë pas kohe u plotësuan me ndërtime të reja. Ardhja e turqve në Rrafshin e Dukagjinit dhe Kosovë me vete e solli një influencë shumë të fortë të kulturës osmane-islame në jetën shpirtërore dhe në kulturën materiale të kësaj treve. Nga dora e pushtuesve shekullorë barbarë numri i objekteve të trashëgimisë kulturore që u shkatërruara është i madh, gjë që në këtë kontekst nënkuptohen përmasat e humbjeve të mëdha të objekteve të trashëgimisë kulturore-historike të trashëguara nga e kaluara në qytetet dhe fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit. Gjatë kësaj kohe duhet veçua qytetin historik të Pejës i cili i ka takuar trevës së të Rrafshit të Dukagjinit i cili ishte nën vasalitetin e Turqisë. Të gjitha këto lëshime shteti turk i kishte bërë në mënyrë që te sigurojë Rrafshin e Dukagjinit për vete, që në prapavijë të sigurojë paqe mu në kohën kur bënte ofensivat e mëdha kundër Serbisë e Hungarisë. Derisa ishin besnikë të sulltanit dukagjinasit i zgjeruan pronat e tyre. Duke u bazuar në shënimet e Sellnames Vilajeti i Kosovës është formuar në vitin 1463, në kohën kur turqit e pushtojnë qytetin historik të Rrafshit të Dukagjinit. Dukagjinasit në këtë kohë detyrohen të heqin dorë nga aleanca me Turqinë, kur Skënderbeu i shkoi në ndihmë mbretit të Napolit, Ferdinandit. Që nga kjo kohë e deri në fund të jetës së vet Lekë Dukagjini bëhet miku dhe bashkëpunëtori më i ngushtë i të madhit Skënderbe. Pra, në dritën e këtyre ngjarjeve rreth viteve 1462/63 pushtohet edhe Rrafshi i Dukagjinit nga Sulltan Mehmeti II. Pas pushtimit të qytetit të rezistencës së madhe shqiptare Shkodrës në vitin 1479 dhe formimit të sanxhakut të këtij qyteti iu bashkuan edhe disa territore të Rrafshit të Dukagjinit. Në këtë kohë qyteti i Pejës me rrethinë, në vitin 1485, ishte pjesë e Sanxhakut të Shkodrës, i cili numëronte tridhjetë e tri familje myslimane në gjashtë lagje dhe njëqind e katër familje krishtere. Gjatë viteve 1490/91 Sanxhaku i Rrafshit të Dukagjinit ishte mjaft i kufizuar, e kjo do të thotë së në kuadrin e tij nuk ishte asnjë vilajet, kurse në kuadër të Sanxhakut të Shkodrës ishin vilajetet: Shkodra, Plava,Peja, Juniku, Deçani, Rugova. Sipas shënimeve të vitit 1528, këtu përmendet edhe Bali Beu i sanxhakut të Rrafshit të Dukagjinit, i cili selinë e ka pasur në qytetin e Pejës, atë kohë është quajtur "Begu i Pejës". E kundërta e këtyre shënimeve janë defterët turq të vitit 1528 - ku thuhet se qyteti kulturor-historik i Pejës ishte në kuadër të Sanxhakut të Shkodrës, e vetë Peja njihet si qytet me emrin "IPEK" e cila në këtë periudhë ishte pronë e sanxhak-beut me të ardhura që kapin shumën tridhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë akçe. Gjatë shekullit XVIII- XIX qyteti i Pejës ishte qendër e Sanxhakut të Rrafshit të Dukagjinit. "Të flasësh për qytetet historik të Rrafshit të Dukagjinit, e sidomos të Pejës i cili ishte një ndër qendrat më të njohura shqiptare qe njihen me lashtësinë e tyre, me pozitën gjeografike, me klimën që e ka, e kushtëzojnë zhvillimin e hovshëm kulturor dhe ekonomik të Rrafshit të Dukagjinit. Të gjitha periudha historike mirë flasin se sidomos qyteti i Pejës dhe Prizrenit kanë qenë vendbanimi më të qytetëruar dhe qendër e civilizimit që daton nga kohërat e hershme. Në bazë të materialeve të zbuluara arkeologjike si fabula, unaza, qafore, gjilpëra, pafta prej agjenti, shtiza, shpata, thika, enë, monedha, helmeta prej bronzit e tjera. Gjatë gërmimeve arkeologjike në Banjë të Pejës në dy varreza, janë gjetur gjëra të argjendta dhe të qelibarit. Nga kjo mund të konstatohet së këtu ka ekzistuar një qendër tregtare, ku ishte edhe banja shëruese, ku kalonin pushimet tregtarët e mëdhenj nga Peja dhe vende të tjera. Gjithashtu në një zbulim arkeologjik që u bë në lindje të qytetit të Pejës në varrezat e qytetareve të përkatësisë islame dhe katolike të cilat populli i quan varrezat latine të kohës antike. Gjatë punimeve në lokalitetin antik në qytetin e Pejës së lashtë, pos fragmenteve të qeramikës, tullave, të hollave, mureve u gjeten edhe gur me vlera të mëdha arkeologjike. Sipas shënimeve të vitit 1582 në qytetin e Pejës ushtroheshin pesëdhjetë e gjashtë zeje, a zejtaret dhe tregtaret ishin shtresa kryesore e qytetareve e cila përfshinte dyzet e tre për qind të popullsisë së qytetit. Qyteti i Pejës në vitin 1838 kishte dy mijë e katërqind shtëpi, prej tyre dy mijë e dyqind e pesëdhjetë myslimanë, njëqind e tridhjetë ortodoksë, njëzet katolikë me dymbëdhjetë mijë banorë dhe nëntëqind e gjashtëdhjetë dyqane. Qyteti i Pejës që nga vitit 1851 e deri 1999 gjashtë herë u bë shkrumb e hi nga dora e pushtuesve shekullorë. Edhe përkundër këtyre pasojave të rënda në periudhën e pasluftës Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve kulturore-historike të Pejës bënë dhe po bëjnë punë të mëdha në regjistrimin, mirëmbajtjen, ruajtjen, restaurimin, inventarizimin e kullave, shtëpive të banimit, xhamive, kishave shqiptare, mullinjve, mejtepeve, hambarëve, varrezave, kalasë, Çarshi-xhamisë e shumë objekteve të tjera me rendësi historike dhe kulturore në këtë pjesë të Rrafshit të Dukagjinit.

# I DASHUR PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR

Supermarketi "Hilal Food Center" dhe pronari z. Mahmud janë tashmë më të dashurit për të gjithë shqiptarët. Z Mahmud është thuajse një shqiptar i vërtetë, ai flet shqip, komunikon mirë me të gjithë klientët e tij nga Shqipëria dhe Kosova dhe uron që pandemia të largohet dhe njerëzit të shpëtojnë nga Covid-19. Ky supermarket prej kohësh është bërë një qendër ku gjendet respekti ndaj shqiptarëve. Pronari i këtij supermarketi, është thuajse një mik i pandashëm me të gjithë. Mahmudi mbetet simboli i Njeriut dhe tregëtarit të dashur për shqiptarët. Njeriu gjithnjë e ka një arsye në tërë udhën e tij të fiksojë atë që lidhet me përditësinë, me ushqimin, si bazën krysore të qasjes së një detyrimi familjar për një shëndet dhe jetë më të mirë, më cilësore. Dhe këtë në Londër, natyrshëm e krijon nga lidhjet dhe sjelljet, cilësia dhe kultura e sërbimit tek "Hilal Food Center" në Kilburn High Road. Ai tashmë është Supermarketi i dashur i shqiptarëve. Dhe këtu pronari i tij Z. Mahmud gjithnjë është i gatshëm dhe mjaft human në ndihmë të të gjithëve. Ndaj këtu çmimet konkurrojnë, cilësia është e garantuar.

"Hilal Food Center" është i rëndësishëm për komunitetet

Ndaj, Supermarketi "Hilal Food Center" është i rëndësishëm për komunitetet që u shërben. Ushqimi është i nevojshëm kudo për të gjithë dhe këtu hyjnë supermarketet. Sa më shumë që keni në qarqet apo provincat tuaja, aq më shumë konkurrencë keni, gjë që ul çmimet (sidomos për artikujt me cilësi më të lartë që gjithashtu tregtohen mirë). Ekipi që keni bashkuar do të përcaktojë nivelin tuaj të shërbimit ndaj klientit, mënyrën se si menaxhohet inventari në të gjithë dyqanin dhe kulturën e përgjithshme (si ndihen të gjithë në dyqan për menaxhimin e sipërm, punët e tyre etj). Shumica e supermarketeve tani shesin të njëjtat produkte organike - / konvencionale kështu që ju duhet të keni një ndryshim në lidhje me biznesin tuaj sesa konkurrentët tuaj.
Shumica e bizneseve përqendrohen në zinxhirët e furnizimit dhe kërkesës. Por "Hilal Food Center" tregon se gjithmonë do të ketë klientë (të gjithë duhet të hanë). Nevojat e "Hilal Food Center" drejtohen nga dy faktorë kryesorë: koha dhe të ardhurat e disponueshme.

Shqiptarët ndjehen si në shtëpinë e tyre tek "Hilal Food Center"

Shqiptarët ndjehen si në shtëpinë e tyre tek "Hilal Food Center". Shërbimet tek "Hilal Food Center" përqendrohen në bërjen e njerëzve për të blerë me ta dhe jo në dikë tjetër. Ata kanë prodhime si buka dhe qumështi afër kostos në mënyrë që të mos humbasin klientët. Kuponë për t'i bërë njerëzit të ndihen mirë me blerjet e tyre. Shumica e njerëzve nuk kanë kohë të bëjnë pazar. Të kesh një supermarket që mbart fruta dhe perime të freskëta është treguesi

numër një i shëndetit të një lagjeje. Dhe këtë e gjeni tek "Hilal Food Center", ku shërbimet dhe produktet e tij janë tregues i rëndësishëm të shëndetit financiar dhe fizik. Shqiptarët flasin fjalët më të mira për "Hilal Food Center". Ata ndjehen gjithnjë si në shtëpinë e tyre dhe në shërbimin profesional dhe model të "Hilal Food Center".



DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT
HILAL FOOD CENTRE
International Food Centre
318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059
VEAL SPECIAL OFFER
INDIAN HEAD
STONE GROUND
KLAS
Zlatni
VITA BONOR
lane
VEGETA
paprika
ARGETA
Chicken Halal
Gondi Narezak
Halal